



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada- Government

2009-2012

**STRATEGJIA SHITETËRORE E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR**

Tetor 2009, Prishtinë



***STRATEGJIA SHETËRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
PARANDALIMIN E KRIMIT DHE PLANI I VEPRIMIT
2009-2012***

PËRMBAJTJA

I. HYRJE	5
II. PARIMET THEMELORE PËR SUKSESIN E STRATEGJISË SHTETËRORE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT	6
1. Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë	6
2. Parimi i profesionalizmit	6
3. Parimi i vazhdimësisë	6
4. Parimi i besueshmërisë	6
5. Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut	6
6. Parimi i sigurisë	6
7. Parimi i proporcionalitetit	6
III. SITUATA AKTUALE	7
IV. VIZIONI DHE MISIONI	8
V. KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NËRKOMBËTARE	8
VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL	8
1. Koordinatorin Nacional	8
2. Sekretariati	8
3. Ministria e Punëve të Brendshme	8
4. Ministria e Drejtësisë	8
5. Agjencia e Kosovare për Inteligjencë	9
6. Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit	9
7. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	9
8. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	9
9. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	9
10. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	9
11. Ministria e Ekonomisë dhe Financave	9
12. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	9
13. Ministria e Shëndetësisë	9
14. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	9
15. Këshilli Gjyqësor i Kosovës	9
16. Këshilli Prokurorial i Kosovës	9
17. Prokuroritë dhe Gjykatat	9
VIII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	10-13
1. Parandalimi i krimit përmes zhvillimit të sistemit të hershëm të intervenimit-reagimit,	
2. Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore,	
3. Avancimi i kapaciteteve institucionale me qëllim të parandalimit të krimit,	
4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit.	
5. Zhvillimi dhe zbatimi masave/shërbimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit.	

IX. ZBATIMI , MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË	13-14
1. Roli i sistemit të monitorimit,	
2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim,	
3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit, treguesit përfundimtarë,	
4. Treguesit e ndërmjetëm,	
5. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit,	
6. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.	
X. PLANI I VEPRIMIT	14
ANEKSI 1. SHKURTESAT	15
ANEKSI 2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NËRKOMBËTARE	16
ANEKSI 3. STATISTIKAT E AKSIDENTEVE TË KOMUNIKACIONIT PËR VITET (2004 – 2009)	17
ANEKSI 4. RAPORTI I LUHATJEVE TË KRIMIT (1/01/2004 – 30/6/2009)	18

STRATEGJIA SHTETËRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR PARANDALIMIN E KRIMIT

I. HYRJE

Në bazë të analizave të ndryshme të kryera deri më tani, vërehet se Republika e Kosovës në krahasim me vendet anëtare të Bashkimit Evropian ka një nivel më të ulët të krimit, përderisa në krahasim me vendet e rajonit, krimi është më i lartë.

Zhvillimi i mëtutjeshëm ekonomik dhe shoqëror si dhe avancimi i Kosovës në procesin e integritimit evropian do të krijojë mundësi më të mëdha për ngritjen e nivelit të krimit, prandaj është e rëndësishme për institucionet e Republikës së Kosovës, që këtij fenomeni t'i qasemi me kohë.

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes hartimit të kësaj strategjie synon që t'i përgjigjet këtij fenomeni në mënyrë parandaluese përmes ndërmarrjes së masave paraprake.

Politika e parandalimit të krimit e Qeverisë së Republikës së Kosovës është element i rëndësishëm i cili synon të jetë mekanizëm nacional për siguri në luftimin dhe parandalimin e krimit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, ka identifikuar që prioriteti kryesor i kësaj strategjie kërkon një përgjigje të integruar në mes të gjithë institucioneve të përqendruar në bashkëpunim.

Përpos përgjegjësive të institucioneve përkatëse për luftimin e krimit, kjo strategji synon krijimin e një mekanizmi shtesë për zvogëlimin e krimit përmes parandalimit.

Parandalimi nënkupton 'të gjitha aktivitetet që ndikojnë në pengimin dhe zvogëlimin e krimit si dukuri shoqërore, si në aspektin sasior ashtu edhe në aspektin cilësor, përmes masave permanente dhe të strukturuar të bashkëpunimit apo përmes iniciativave të kohë pas kohëshme (ad hoc).

Nevoja për hartimin e kësaj strategjie vjen si domosdoshmëri dhe si një kërkesë për orientimin e aktiviteteve specifike të policisë dhe institucioneve tjera në drejtim të planifikimit, krijimit dhe implementimit të Planit Veprues, në parandalimin e krimit.

Kjo strategji është një dokument i cili përcakton synimet, parimet themelore, përcakton objektivat, institucionet përgjegjëse dhe mënyrat për arritjen e suksesit në parandalimin e krimit.

Kjo strategji e parandalimit të krimit përfshin:

- Ndërtimin e një sistemi të hershëm të intervenimit-reagimit me qëllim për parandalim të krimit.

-Zhvillimin dhe zbatimin e masave/shërbimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit.

-Masat rrethore me fokus në masat teknike, përfshirë planifikimin urban, që të ofrohet një siguri publike, të limitohen mundësitë e kryerjes së krimit, rritja e rrezikut të kapjes për kundërvajtësin dhe të reduktohen përfitimet nga krimi.

-Informimi i qytetarëve për situatën e sigurisë, e po ashtu edhe për këshillat mbi sigurinë dhe promovimin e angazhimeve direkt me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve, që të ndërmarrin hapa pro aktiv në përmirësimin e sigurisë së tyre dhe sigurisë së fqinjësisë së tyre.

-Ndërtimi i kapaciteteve të nevojshme, forcimin e sistemit të propozuar për parandalimin e krimit, përmirësimi i kushteve të implementimit përmes një përkrahje nacionale dhe lokal.

Objektivat e kësaj Strategjie do të mbulojnë periudhën kohore për tri vitet e ardhshme (2009 – 2012).

II. PARIMET THEMELORE PËR SUKSESIN E STRATEGJISË SHETËTËRORE PËR PARANDALIMIN E KRIMIT

Në përmbushjen e objektivave të parapara në Strategjinë Shtetërore për Parandalimin e Krimit, institucionet e Republikës së Kosovës udhëhiqen nga parimet vijuese:

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë – Veprimet e ndërmarra për parandalimin e krimit duhet të bazohen në dispozitat e parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjisllacionin në fuqi si dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Parimi i profesionalizmit – Parandalimi i krimit kërkon ekspertë të mirë, shkëmbim të përvojave, mjete të përshtatshme dhe praktikata më të mira. Kjo nënkupton kombinim të trajnimit, edukimit dhe zhvillimit profesional për institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe përkujdesjen për të rekrutuar vetëm specialistët e cilësisë më të mirë.

Parimi i vazhdimësisë – Aktivitetet duhet të shihen si pjesë e një strategjie të vazhdueshme.

Parimi i besueshmërisë - Institucionet përgjegjëse për parandalimin e krimit duhet të kujdesën për ndërtimin e besimit në ruajtjen e integritetit të hetimeve, të dhënave dhe informacioneve nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to.

Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut - Ky parim nënkupton garantimin e lirive dhe të drejtave të të gjithë individëve, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin e krimit.

Parimi i sigurisë - Ky parim nënkupton garantimin e së drejtës për siguri dhe mbrojtje për të gjithë qytetarët nëpërmjet parandalimit të të gjitha formave të krimit.

Parimi i proporcionalitetit - Nënkupton ushtrimin e autoritetit të institucioneve që merren me parandalimin e krimit atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme, në një kohë sa më të shkurtër të mundshme dhe me pasojë sa më të vogla.

III. SITUATA AKTUALE

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit ka ndërmarrë një varg aktivitete duke hartuar Strategjitë Kombëtare kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Drogave, Krimit të Organizuar, Terrorizmit dhe Strategjinë Kombëtare për Menaxhim të Integruar Kufirit, me të cilat janë paraparë veprime dhe masa konkrete për parandalimin dhe luftimin e këtyre dukurive negative.

Situata aktuale në Kosovë tregon se ende ekzistojnë probleme të natyrave të ndryshme, vepra penale të cekura më poshtë të cilat nuk janë të përfshira në strategjitë e mëhershme.

Edhe pse viteve të fundit në përgjithësi vërehen rënje të nivelit të krimit mbetet ende shqetësuese fakti i rritjes së disa lloje të veprave penale.

Duke iu referuar të dhënave statistikore të policisë së Kosovës (2004-2008 dhe gjashtëmuajorit të parë të vitit 2009), për përgatitjen e kësaj strategjie vërehet se ka rritje të nivelit të krimit në këto fusha:

- Grabitjet / Vjedhjet grabitqare;
- Pushtim i paligjshëm i pronës së paluajtshme;
- Vjedhje e rëndë;
- Lëndim i rëndë/ Lëndim i lehtë trupor;
- Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm;
- Tentim vrasje;
- Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik.

Vrasjet si kategori më e rënde e veprave penale, viteve të fundit, shënojnë rënie por krahasuar me trendin e kësaj vepre me shtetet e rajonit, në Kosovë është më e shprehur.

Gjatë kësaj periudhe analizat tregojnë se edhe fenomeni i vetëvrasjes shfaqet si dukuri mjaft shqetësuese për institucionet dhe shoqërinë e Kosovës.

Numri i krimeve të evidentuara në Kosovë është përafërsisht 3000 për 100 000 banorë, që është dukshëm më i ulët sesa mesatarja e mostrës nga një grup i përbërë prej njëmbëdhjetë shteteve anëtare të BE-së. Megjithatë, në raport me Maqedoninë shkalla e nivelit të krimeve në Kosovë është përafërsisht tri herë më e lartë. Ndërsa, në raport me Kroacinë, Kosova shënon 30% trend më të lartë të krimit¹, andaj edhe mund të ketë arsye për shqetësim.

¹ Raporti i parë i monitorimit nga EULEX-i, 2009

IV. VIZIONI DHE MISIONI

1. Vizioni

Vizioni i kësaj strategjie është që t'i qasemi krimit në mënyrë parandaluese me qëllim të ngritjes së sigurisë në Republikën e Kosovës.

2. Misioni

- Që të përqendrohet në veprimet e institucioneve shtetërore dhe të shoqërisë civile për **krijimin e rrethanave** që do të mundësojnë një nivel të lartë të cilësisë së jetës individuale dhe shoqërore, duke zvogëluar kështu krimin dhe duke siguruar jetën në një mjedisi të sigurt;
- Që të sigurojë **veprim të bashkërenditur** të degës së legjislativit, të ekzekutivit, të gjyqësorit dhe të institucioneve të tjera, si dhe bashkëpunimin e tyre me organizatat joqeveritare dhe me organet e tjera të shoqërisë civile në formësimin dhe zbatimin e strategjisë për parandalim të krimit;
- Që të përcaktohen **fushat kryesore** të sigurisë shtetërore dhe të elaborohen **udhëzimet** në fushën e parandalimit dhe të shtypjes së krimit, duke krijuar kështu kushtet për integrimin e politikës kundër krimit në të gjitha politikatat, posaçërisht në fushën e parandalimit të krimit.

VI. KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NËRKOMBËTARE

Në fushën e parandalimit Republika e Kosovës ka një baze të gjërë ligjore, të paraqitura në ANEKSIN 2.

VII. MEKANIZMAT INSTITUCIONAL

Mekanizmi institucional nënkupton të gjithë institucionet të cilat kanë rëndësi në koordinimin e aktiviteteve në parandalimin e krimit.

Parandalimi dhe luftimi i krimit në Republikën e Kosovës është detyrë dhe përgjegjësi e të gjitha institucioneve:

1. Koordinatori Nacional - Koordinatori Nacional është organ individual përgjegjës për koordinimin, bashkërendimin, monitorimin dhe raportimin e implementimit të politikave, aktiviteteve dhe veprimeve lidhur me parandalimin e krimit.

2. Sekretariati – Të drejtat e sekretariatit dhe përgjegjësitë kryesore janë mbledhja e informatave dhe shënimeve nga institucionet e tjera, me qëllim të hulumtimit dhe vlerësimit të informatave si dhe të përgatitjes së raportit analitik për koordinatorin nacional.-(të merret definimi nga strategjia tjera).

3. Ministria e Punëve të Brendshme – MPB-ja ka rol shumë të rëndësishëm në arritjen e objektivave të kësaj strategjie. Policia e Kosovës si agjencion për zbatimin e ligjit në kuadër të MPB-së ka rol dhe rëndësi të veçantë në parandalimin dhe luftimin e të gjitha llojeve të krimit.

4. Ministria e Drejtësisë - Angazhohet në forcimin dhe funksionalizimin e sundimit të ligjit, krijon kushte të nevojshme për prokuroritë në parandalimin e krimit dhe harton plane dhe programe për risocializimin dhe ri-integrimin e të burgosurve dhe kryesve me dënime alternative.

5 Agjencia Kosovare për Inteligjencë- mbledh, vlerëson dhe përcjell informacione në lidhje me kërcimet nga aktivitetet kriminale.

6 Agjencioni Kosovar kundër Korrupsionit – zbulon, heton dhe përcjell në Prokurori rastet e krimeve

me natyrë korruptive si dhe ndërmer masa për parandalimin e korrupsionit përmes mbikëqyrjes së pasurive të zyrtarëve të lartë dhe parandalimit të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike.

7. Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë - luan rol të rëndësishëm në parandalimin e krimit nëpërmjet edukimit, përmes plan-programeve mësimore, qasjes ndër programore dhe aktiviteteve të ndryshme jashtë-programore.

8. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit, politikave, planeve strategjike e standardeve me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve në gjendje të nevojave sociale.

9. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- luan rol të rëndësishëm në parandalimin e krimit në bashkëpunim me institucionet tjera si: policinë, doganat, agjencionin kundër korrupsionit, përmes luftimit të ekonomisë informale.

10. Ministri e Administrimit të Pushtetit Lokal – mbështet komunat në parandalimin e krimit duke identifikuar nevojat për aktivitetet e trajnimit të komunave, ndihmon komunat që aktivitetet e tyre të bëhen transparente për publikun si dhe ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve ligjore për komunat.

11. Ministria e Ekonomisë dhe Financave- luan rol në sigurimin e të hyrave dhe parandalimin e pastrimit të parasë përmes agjencioneve të veta si: Dogana e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës.

12. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit - në kuadër të strategjisë për parandalimin e krimit ka rol në organizimin e aktiviteteve (fushatave) sensibilizuese me të rinjtë, me qëllim të edukimit dhe vetëdijesimit për parandalimin e përfshirjes së të rinjve në aktivitete (trafikimit, prostitucionit dhe drogave) dhe parandalimit të tyre.

13. Ministria e Shëndetësisë – ka për objektiv mbrojtjen shëndetësore, ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve të cilat do të jenë në shërbim të plotë të qytetarëve dhe të gjitha institucioneve relevante për parandalimin e krimit.

14. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor – është përgjegjëse për hartimin legjislacionit në fushat e mbrojtjes së mjedisit, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit, si dhe për monitorimin dhe zbatimin e tij. Në kuadër të strategjisë, MMPH do të jetë transparente dhe kooperative me institucionet relevante për parandalimin e krimit.

15. Këshilli Gjyqësor i Kosovës -siguron që gjykatat në Kosovë të jenë të pavarura, profesionale dhe të paanshme, me qëllim që sistemi gjyqësor të jetë sa më efikas në luftë kundër krimit të organizuar dhe formave tjera të kriminalitetit

16. Këshilli Prokurorial i Kosovës - siguron që sistemi prokurorial në Kosovë të jetë i pavarur, i paanshëm dhe profesional në ushtrimin e ndjekjes , hetimit, dhe zbulimit të veprave penale, të përfaqësorë në gjykata aktet akuzuese në emër të shtetit.

17. Prokuroritë dhe Gjykatat - janë institucionet përgjegjëse për ndjekjen penale të kryesve ndëshkimin adekuat të tyre, për konfiskimin e pasurisë dhe asetëve të fituara me anë të aktiviteteve kriminale.

Në kuadrin institucional, një rol të rëndësishëm për parandalim dhe luftim të krimit të organizuar luajnë edhe institucionet tjera vendore dhe institucionet ndërkombëtare partnere prezente në Kosovë por edhe jashtë saj.

Struktura Organizative e Mekanizmit Koordinues, Monitorues dhe Implementues për Parandalimin e Krimit

Koordinatori Nacional

Sekretariati

Grupi Punues Ndërministror

Kordinatori Nacional (MPB)
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
Ministria e Drejtësisë,
Ministria e Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Çështjeve Jorezidente,
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale,
Ministria e Shëndetësisë
Ministria e Ekonomis & Financave
Përfaqësues të OJQ-ve
Anëtarë që ftohen kohë pas kohe, varësisht prej çështjes që shtjellohet.

Niveli strategjik

Niveli operativ

Parandalimi i krimit përmes zhvillimit të sistemit të hershëm të intervenimit-reagimit.

MPB, Policia e Kosovës, MASHT, MSH, MPMS, MKRS, MEM

Komunat, Shoqëria Civile

Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore.

ZKM, MPB, MD
MAPL, MMPH, MASHT, MKRS, AKK,

Kuvendi i Kosovës.

Avancimi i kapaciteteve institucionale me qëllim të parandalimit të krimit.

MPB, MD, MPMS, MMPH, MAPL, MD, KGJK, KPK

Zhvillimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit.

MPB, MAPL, MD, MASH, T, MSH, Prokuroria, Gjykata, Shoqëria Civile, Forumet për Siguri në Bashkësi, OJQ-të, Mediat.

Zhvillimi dhe zbatim i masave/shër bimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit.

MPB, MPMS, MSH, MASHT, MKRS, MD

VIII. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivat strategjike të kësaj strategjie, synojnë të sigurojnë përgjigje adekuate për parandalimin e krimit si dhe përfshijnë:

- 1. Parandalimin e krimit përmes zhvillimit të sistemit të hershëm të intervenimit-reagimit,**
- 2. Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore,**
- 3. Avancimi i kapaciteteve institucionale me qëllim të parandalimit të krimit,**
- 4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit,**
- 5. Zhvillimi dhe zbatimi masave/shërbimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit.**

Objektivat strategjike të cekura më lartë detajizohen tutje më poshtë:

1. Parandalimi i krimit përmes zhvillimit të sistemit të hershem të intervenimit-reagimit

Parandalimi i krimit është koncept i cili duhet të zhvillohet në institucionet lokale, fillimisht në nivel të ulët, ku krimi kryesisht ka për cak bashkësinë.

Komunat dhe stacionet lokale të policisë, janë entitetet e para të cilat duhet të merren me problemin, prandaj fokusi në zhvillimin institucional duhet të vendoset në to.

Për të parandaluar krimin është shumë me rëndësi që të ekzistojë një sistem i mbledhjes së të dhënave jo vetëm kuantitative por edhe atyre kualitative, për të identifikuar rastet potenciale për krim dhe që do të shërbejnë në analizat e institucioneve për zbatimin e ligjit rreth ndërmarrjes së masave që do të ndikojnë në parandalimin e krimit. Në këtë kontekst, është shumë me rëndësi që Kosova të avancojë sistemin me të dhëna kualitative për të kontribuar në:

- 1.1 Fuqizimin e strategjisë për siguri në shkolla;
- 1.2 Zhvillimin e sistemit/programit efikas dhe aktual të parandalimit të krimit. (Identifikimi shkaqeve, përcaktimi i prioriteteve, ngritja e vetëdijës, vlerësimi, modeli SARA);
- 1.3 Vlerësimi i trendëve dhe tendencave të krimit sipas metodologjisë së miratuar;
- 1.4 Ngritja e vetëdijës së institucioneve lokale për intervenimet/reagimet e mundshme për parandalim të krimit, përmes përfshirjes së tyre në sistemin/programin e parandalimit të krimit;
- 1.5 Angazhimi i shoqërisë civile përmes përfshirjes së tyre në sistemin/programin e parandalimit të krimit.

2. Zhvillimi i mëtutjeshëm i infrastrukturës ligjore

Megjithëse korniza ligjore e Kosovës është e kompletuar dhe e zhvilluar gjerësisht, duhet të merret nën konsideratë rishikimi, ndryshimi dhe/ose hartimi i mundshëm i bazës ligjore ekzistuese/të re, për t'u marrë me tendencat e reja, të vlerësuara përmes vlerësimeve të rregullta të trendëve të krimit.

- 2.1 Identifikimi se a ka kapacitet korniza ligjore ekzistuese për të mbuluar trendët/tendencat e reja të krimit;
- 2.2. Zhvillimi dhe/ose avancimi i kornizës ligjore për luftimin efektiv të trendëve/tendencave të reja të

krimit.

3. Avancimi i kapaciteteve institucionale me qëllim të parandalimit të krimit

Qeveria e Kosovës tashmë ka krijuar organet institucionale nëpër komuna dhe bashkësi lokale. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe Komiteti Lokal për Siguri Publike (KLSP), janë entitetet themelore të përbëra nga të gjithë akterët kryesor të identifikuar për të bërë zhvillimin e sistemit/programit për intervenim/reagim të hershëm.

Mirëpo, për të parandaluar me sukses krimin, është e domosdoshme që institucionet përgjegjëse të kenë burime njerëzore të mjaftueshme, të aftësuara, të specializuara dhe të pajisura me mjete teknike dhe teknologjinë e nevojshme për parandalimin e krimit.

Ndërtimi i kapaciteteve të institucioneve me qëllim të parandalimit të krimit përfshinë një sërë masash të cilat kanë për qëllim:

- 3.1 Fuqizimin e kapaciteteve njerëzore të institucioneve që merren me parandalimin e krimit;
- 3.2 Themelimin dhe funksionalizimin e institucioneve tjera për parandalimin e krimit;
- 3.3 Fuqizimin e strukturave të policisë dhe institucioneve tjera që merren me parandalim të krimit me personel dhe pajisje;
- 3.4 Operacionalizimi i veprimit të policisë në komunitet.

4. Zhvillimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit

Parandalimi është aktivitet që duhet të kryhet me një qasje shumë-institucionale. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet të gjithë akterëve kryesorë në zhvillimin e sistemit/programit të intervenimit/reagimit të hershëm, është element thelbësor për arritjen e çfarëdo rezultati. Bashkëpunimi dhe koordinimi përfshinë një sërë masash të cilat kanë për qëllim:

- 4.1 Avancimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore (Ministritë dhe Institucionet lokale);
- 4.2 Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit, shoqërisë civile dhe mediave;
- 4.3 Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet forumeve për siguri në bashkësi dhe iniciativave të reja (KKSB-ve, EVSB-t, KLSP-ve; QSP; etj);
- 4.4 Këmbimi i praktikave (sukseset dhe dështimet) ndërmjet institucioneve;
- 4.5 Identifikimi i praktikave më të mira dhe trendëve pozitiv për parandalimin e krimit përmes bashkëpunimit dhe koordinimit ndërkombëtar.

5. Zhvillimi dhe zbatimi masave/shërbimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit

Zhvillimi dhe zbatimi masave/shërbimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit përfshinë një sërë masash të cilat kanë për qëllim:

- 5.1. Identifikimi i individëve me rrezik potencial për t'u bërë viktima dhe për të kryer krime;
- 5.2. Ofrimi i këshillave (psikologjike, pedagogjike) dhe shërbimeve sociale me qëllim të parandalimit të krimit.

IX. ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I STRATEGJISË

1. Roli i sistemit të monitorimit

Procesi i zbatimit të strategjisë do të përfshijë arritjet e objektivave strategjike, objektivat specifike dhe aktivitetet. Rezultatet e monitorimit dhe vlerësimit për arritjen e objektivave dhe efektiviteti i aktiviteteve përkatëse është pjesë integrale e procesit të strategjisë dhe komponentë kyçe për realizimin e saj. Monitorimi dhe vlerësimi do të sigurojnë mjete për matjen e përparimit në lidhje me objektivat e përmendura, veçanërisht në lidhje me aktivitetet.

Procesi i monitorimit do të realizohet nga institucionet përgjegjëse me pjesëmarrjen e gjerë të grupeve të interesuara.

Dimensionet kryesore të monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë janë:

Kapacitetet institucionale;

Treguesit e monitorimit përgjatë dhe në fund të periudhës tri vjeçare;

Burimet e informacionit dhe instrumentet matëse;

Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit.

2. Kapacitetet institucionale për monitorim dhe vlerësim

Sistemi i monitorimit dhe vlerësimit, do të shtrihet në të gjitha institucionet përgjegjëse për realizimin e objektivave të përcaktuara në strategji dhe planin e veprimit.

Ministria e Punëve të Brendshme (Sekretariati), si bartëse dhe përgjegjëse kryesore për realizimin e objektivave, do të krijojë planin e monitorimit dhe njësitin e vlerësimit të strategjisë në vartësi të Koordinatorit Nacional. Kjo njësi do të monitorojë treguesit më të rëndësishëm në lidhje me parandalimin dhe zvogëlimin e krimit. Në fund të çdo viti, duhet të përgatisë një raport progresi mbi shkallën e realizimit të objektivave.

Ministritë e linjës (MPB, MD, MASHT, MEF, MSH, MPMS, MAPL, MKRS, MBZHR), do të përgjigjen për monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve që kanë si bartës këto ministri ose institucione në vartësi të tyre. Këto institucione do t'i raportojnë periodikisht Koordinatorit Nacional, në mënyrë që raportet të jenë të unifikuara.

Organizatat Jo-qeveritare, do të marrin pjesë në monitorimin dhe vlerësimin në tryeza të përbashkëta që do të organizohen nga koordinatori. Në këto tryeza, shoqëria civile do të paraqesë raporte vëzhguese që lidhen me projektet dhe programet që ato kanë realizuar.

3. Zgjedhja e treguesve të monitorimit dhe vlerësimit

Treguesit përfundimtar

1. Numri i ligjeve dhe akteve nën ligjore në fuqi pasi është miratuar strategjia;
2. Raportet e monitorimit dhe vlerësimit të strategjisë;
3. Përqindja e popullsisë së vetëdijesuar për rrezikun që paraqet krimi;
4. Numri i përgjithshëm i krimeve, të ndara sipas llojit dhe vendit;
5. Numri i përgjithshëm i raportimeve nga ana e qytetarëve.

4. Treguesit e ndërmjetëm

Treguesit e ndërmjetëm janë treguesit e monitorimit të aktiviteteve në Planin e Veprimit për parandalimin e krimit.

5. Instrumentet e monitorimit dhe vlerësimit

Sistemi i standardizuar i mbledhjes dhe përpunimit të informacionit;

Të dhënat administrative, statistikore të MPB-së (Departamenti i Sigurisë Publike, Policisë), Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave (Dogana, Administrata Tatimore e Kosovës), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Prokurorisë, Gjykatave, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale;

Anketime dhe vrojtime të popullatës mbi shkallën e vetëdijesimit për çështjet e çfarëdo lloj krimi.

6. Shpërndarja dhe përdorimi i rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit

Rezultatet e monitorimit dhe të vlerësimit shpërndahen me qëllim të avancimit të përparimit në zbatimin e strategjisë për parandalimin e krimit. Rezultatet do të bazohen në të dhëna të ofruara nga institucionet të përfshira në këtë strategji:

1. Institucionet shtetërore qendrore dhe lokale;
2. Shoqëria civile;
3. Mediat;
4. Publiku i gjerë etj.

X. PLANI I VEPRIMIT

Plani i veprimit hartohet brenda kornizës së përgjithshme strategjike të përcaktuar në strategjinë shtetërore kundër krimit të organizuar.

Plani veprues për zbatimin e kësaj strategjie do të përmbajë:

1. Objektivat e strategjike;
2. Objektivat specifike;
3. Aktivitetet konkrete për realizimin e objektivave;
4. Përcakton institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse për arritjen e secilit objektiv dhe aktivitet;
5. Saktëson kornizën kohore për realizimin e secilit objektiv;
6. Përcakton burimet e nevojshme financiare për zhvillimin e aktiviteteve.
7. Përcakton indikatorët apo treguesit për realizimin e secilit objektiv dhe aktivitet.

Plani veprues duhet të tregojë lidhshmëri me kornizën e përgjithshme të strategjisë shtetërore kundër krimit të organizuar të Republikës së Kosovës.

ANEKSI 1

SHKURTESAT

AKI	Agjencia Kosovare e Inteligjencës
BE	Bashkimi Evropian
DK	Doganat e Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit
ICITAP	Programi dhe Trajnimi Ndihmës në Hetimin e Krimit Ndërkombëtar
ZCN	Zyra Civile Ndërkombëtare
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPK	Kodi Penal i Kosovës
KPPK	Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MIA	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Post - Telekomunikacionit
OSBE	Organizata për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë
PK	Policia e Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
ZKM	Zyra e Kryeministrit
KKSB	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
EVS	Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
KLSB	Komiteti Lokal për Siguri në Bashkësi
MIK	Menagjimi i Integruar i Kufirit
MM	Marrëveshjet e Mirëkuptimit

ANEKSI 2

KORNIZA LIGJORE DHE INSTRUMENTET NËRKOMBËTARE

1. Dokumentet referuese të Republikës së Kosovës

Në fushën e parandalimit, Republika e Kosovës ka një bazë të gjerë ligjore, ku si legjislacion parësor mund të përmendën por nuk kufizohen vetëm në:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për Policinë;
- Kodi Penal i Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale;
- Ligji për Prokuroritë Publike;
- Ligji për Organizimin e Gjykatave;
- Ligji Penal për të Mitur;
- Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë ;
- Ligji Kundër Korrupsionit;
- Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
- Ligji për Administrimin e Pasurisë së Konfiskuar dhe Sekuestruar;
- Ligji për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorëve;
- Kodi Doganor dhe i Akcizave;
- Strategjia Nationale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore;
- Strategjia Nationale kundër Krimit të Organizuar;
- Strategjia në Parandalimin e Incidenteve në Shkolla.

2. Konventat dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Kosovës, që kanë ndikim në parandalimin e krimit janë:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj;
- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera;
- Konventa e Kombëve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve;
- Konventa e Kombëve të Bashkuara për parandalimin e krimit -2002;
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas ;
- Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor;

ANEKSI 3

STATISTIKAT E AKSIDENTEVE TË KOMUNIKACIONIT PËR VITET 2004 - 2009

VITI	AKSIDENTE FATALE	AKSIDENTE ME LËNDIME	AKSIDENTE ME DËME MATERIALE	AKSIDENTE GODIT E IK	TOTAL AKSIDENTE	PERSONA TË VDEKUR	PERSONA TË LËNDUAR
2004	141	1326	5097	0	6564	170	2053
2005	145	2506	10963	303	13917	155	4206
2006	156	3013	10839	574	14582	178	4789
2007	128	3901	12225	749	17002	139	6264
2008	118	3850	11313	658	15939	133	6427
2009 Jan- Gusht	98	3131	8655	620	12504	114	5177
TOTAL	786	17727	59092	2904	80509	889	28916

* Të dhënat statistikore të SIPK-së, të Policisë së Kosovës 2004-2009

ANEKSI 4

Raporti vjetor i luhatjeve të krimit
Periudha e mbuluar: 01/01/2004 – 30/6/2009

Veprat penale	Viti-2004	Viti-2005	%	Viti 2006	Viti 2007	%	Viti 2008	Janar- Qershor 2009
	Të kompletuara	Të kompletuara	Të kompletuara	Të kompletuara	Të kompletuara	Të kompletuara	Të kompletuara	
Veprat penale kundër jetës dhe trupit								
Tentim vrasjet	174	243	39.66	179	155	-13.41	190	76
Sulmet seksuale	45	57	26.67	63	94	49.21	45	16
Grabitje / vjedhje grabitqare	408	486	19.12	456	460	0.88	476	293
Lëndimi i rëndë trupor	453	449	-0.88	412	2894	602.43	447	212
Dhunimet	64	57	-10.94	62	51	-17.74	48	15
Vrasjet	78	67	-14.10	61	65	6.56	55	11
Kidnapimet	86	73	-15.12	45	59	31.11	48	18
Veprat penale kundër pasurisë								
Pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme	120	138	15.00	150	25	-83.33	276	77
Vjedhja e rëndë	3875	4002	3.28	4869	5320	9.26	6282	2760
Vjedhjet	7332	7182	-2.05	7771	7182	-7.58	8278	3228
Dëmet Kriminale	2536	2461	-2.96	2689	2618	-2.64	3294	1328
Vjedhjet e veturave	752	638	-15.16	476	329	-30.88	424	205
Mashtrimet	620	478	-22.90	538	491	-8.74	747	200
Veprat penale kundër rendit publik dhe veprimeve juridike								
Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare	832	847	1.80	815	1025	25.77	633	261
Trazirat	26	1	-96.15	0	2		0	2
Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm	88	107	21.59	423	450	6.38	893	380
Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve	1269	1433	12.92	1404	1482	5.56	1417	587
Krime tjera / Incidente								
Falsifikimi i parasë	502	381	-24.10	345	963	179.13	1124	325
Falsifikim i dokumenteve zyrtare	2152	1464	-31.97	1340	1265	-5.60	1128	xxxxx
Totali	21412	20564	-3.96	22098	24930	12.82	25805	9994